

# PËRSHTATJA NDAJ NDRYSHIMEVE KLIMATIKE NËPËRMJET MENAXHIMIT NDËRKUFITAR TË RREZIKUT NGA PËRMBYTJET NË BALLKANIN PERËNDIMOR



**SHTRIRJA E PROJEKTIT**  
**BASENI I DRINIT ALB/MNE/**  
**RKS/RMV**




**FINANCIIMI**  
**GRANT: 4,500,000 EURO**



**DONATORI:**  
**BMZ/GIZ**



**PËRFITUES**  
**AMBU/MTM**



**KOHËZGJATJA E PROJEKTIT**  
**2012-2022**



**REALIZIMI**  
**100%**



## REZULTATET E PROJEKTIT

Projekti synon të forcojë kapacitetet për menaxhimin ndërkufitar të rrezikut nga përmbytjet si pasojë e ndryshimeve klimatike në Ballkanin Perëndimor.

Objektivat kryesore të projektit janë:

- Zbatimi i mëtejshëm i Direktivës së BE-së “Për përmbytjet”;
- Rritja e aftësisë të institucioneve për të ofruar paralajmërim të hershëm, kuptimplotë dhe në kohë për të gjithë popullsinë;
- Forcimi i kapaciteteve institucionale për koordinimin strategjik të menaxhimit të rrezikut nga përmbytjet;
- Zhvillimi i Planit të Menaxhimit të Rrezikut nga Përmbytjet, Qarku Shkodër.

## PËRSHKRIMI I PROJEKTIT

Projekti ka nisur në vitin 2012 dhe aktualisht është në fazën e tij të tretë (2018-2022). Si në fazat paraardhëse, projekti vazhdon të përqendrohet në basenin e lumit Drin. Ai mbështet institucionet në Shqipëri, Kosovë, Mal të Zi dhe Maqedoninë e Veriut. Ai përmirëson aftësitë e aktorëve në nivel kombëtar dhe në zonat pilote të përzgjedhura në të katër vendet, për një administrim praktik të rrezikut ndaj përmbytjeve, duke ofruar këshillim teknik dhe duke promovuar shkëmbimin ndërkufitar të informacionit.

Duke u mbështetur në arritjet e mëparshme, projekti synon të konsolidojë rezultatet lidhur me parashikimin e përmbytjeve, vlerësimin e rrezikut dhe gatishmërinë për reagim në nivel vendos. Në veçanti, projekti do të mbështesë krijimin e hartave të fatkeqësive dhe rrezikut nga përmbytjet. Paralelisht, projekti do të kontribuojë për dhënien e paralajmërimeve të hershme efektive, në kohë për të gjithë popullsinë që gjendet në basenin e lumit Drin.

## PUBLIKIME

<https://www.giz.de/en/worldwide/29000.html>

<http://www.ambu.gov.al/publikimi-i-raportit-paraparak-te-vleresimit-strategjik-mjedisor-te-planit-te-menaxhimit-te-rrezikut-nga-permbytjet/>